



RAPORT I AVOKATIT TË POPULLIT

**mbi hetimin në lidhje me Ankesën e Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit, Haxhi Shalës
dhe Isni Kilajt**

**kundër Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Kërkesë që Avokati i Popullit të
ushtrojë kompetencën e tij sipas nenit 49(5) të Ligjit nr.05/L-053 për Dhomat e
Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") për t'i
referuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese aspektin e
kushtetutshmërisë të Rregullores KSC-BD-25/Rev1.**

Nr. OMB-C-2024-02/01
Lëshuar më 8 maj 2024

PUBLIK

Më 8 maj 2023, Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës ('Avokati i Popullit),

Pasi mori në shqyrtim ankesat e lartpërmendura, të paraqitura në bazë nenit 162(11) të Kushtetutës së Kosovës ('**Kushtetuta**'), nenit 34(9) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ('**Ligjit**') dhe rregullave 28 dhe 29 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ('**Rregullorja**') mbi krijimin e Zyrës së Avokatit të Popullit dhe në bazë të Procedurës së Ankesave të Zyrës së Avokatit të Popullit të miratuar nga Avokati i Popullit më 12 shtator 2018,

Pas shqyrtimit të kryer, merr këtë vendim:

I. PROCEDURA PARA AVOKATIT TË POPULLIT

1. Ankesa u regjistrua në Zyrën e Avokatit të Popullit më 25 prill 2024.
2. Në mbështetje të ankesës së tyre, mbrojtësit, në emër të parashtruesve të ankesës (mbrojtësit), dorëzuan dokumentet në vijim (1) një kopje të Kërkesës Referuese KSC-BD-25-Rev1 të Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës drejtuar



Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese; (2) një kopje të Kërkesës së Isni Kilajt për t'iu bashkuar Kërkesës Referuese të lartpërmendur, përfshirë (3) Shtojcat Publike 1 dhe 2, që përfshijnë detajimin e honorarëve të ndihmës juridike sipas Rregulloreve të vitit 2020 dhe 2024, si dhe aktet nënligjore të Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës për ndarjen e mjeteve për të akuzuarit para Dhomave të Specializuara; (4) Shtojcat konfidenciale 3 deri 5, të cilat përfshijnë shkëmbimet me e-mail ndërmjet Zyrës Administrative dhe mbrojtësit të z. Kilaj; dhe (5) Kërkesën nga Shoqata e Mbrojtësve që ushtrojnë profesionin para Gjykatave dhe Tribunalëve Ndërkombëtarë (ADC-ICT) për t'u paraqitur si *amicus curiae* para Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.

II. FAKTET

3. Pas shqyrtimit të korrespondencës së dorëzuar nga parashtruesit e ankesës, përfshirë dokumentet e paraqitura para Avokatit të Popullit, faktet përmbledhen si vijon:
4. Parashtruesit e ankesës aktualisht janë në proces gjyqësor para Dhomave të Specializuara në lidhje me shkelje të pretenduara kundër administrimit të drejtësisë. Z. Januzi dhe z. Bahtijari mbahen në paraburgim nga Dhomat e Specializuara që nga 5 tetori 2023. Z. Shala mbahet në paraburgim nga Dhomat e Specializuara që nga 11 dhjetori 2023. Z. Kilaj mbahet në paraburgim që nga 3 nëntori 2023.
5. Z. Januzi, z. Bahtijari dhe z. Shala janë në pritje të gjykimit, për të cilin data e kalimit të dosjes së çështjes gjyqësore Trupit Gjykses është caktuar 21 qershori 2024¹.
6. Prokurorja e Specializuar ende nuk ka dorëzuar aktakuzë për çështjen gjyqësore të z. Kilaj, ai aktualisht konsiderohet i dyshuar.²
7. Më 22 shkurt 2024, Administratorja e Dhomave të Specializuara të Kosovës miratoi rishikimin e Rregullores për Ndihmë Juridike, KSC-BD-25/Rev1 (Rregullorja e vitit 2024).

¹ KSC-BC-2023-10/F00233, *Vendim që Përcakton Kalendarin për Hapat e Mbetur Proceduralë të Fazës së Procedurës Paraprake*, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, 27 mars 2024, publik, paragrafi 30(k)

² KSC-CC-2024-23/F00005, *Kërkesa e Kilajt për t'iu Bashkuar Kërkesës Referuese drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese*, 21 prill 2024, paragrafi 9.



8. Më 2 prill 2024, mbrojtësi i z. Januzi, Xhonathan Elistan Ris, KC, mbrojtësja e z. Bahtijari, dr. Felisiti Geri, KC, dhe mbrojtësi i z. Shala, z. Tobi Kadman, i dorëzuan një kërkesë referuese Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me kushtetutshmërinë e Rregullores së vitit 2024³. Z. Kilaj kërkoi t'i bashkohej Kërkesës Referuese në fjalë në Kërkesën e dorëzuar më 21 prill 2024.⁴
9. Në ankesë mbrojtësit i parashtruan Dhomës se të drejtat e klientëve të tyre sipas neneve 30 dhe 31 të Kushtetutës, si dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa"), u shkelën kur Administratorja miratoi disa ndryshime në Rregulloren për Ndihmë Juridike të vitit 2020. Gjithashtu, parashtruesit e ankesës kundërshtuan "kushtetutshmërinë" e Rregullores për Ndihmë Juridike të vitit 2024 dhe kërkuan që, në përputhje me Rregulloren e DHSGJK-së, Dhoma ta shpallë këtë Rregullore të papajtueshme me Kushtetutën.
10. Më 24 prill 2024, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese lëshoi Vendimin mbi Kërkesën Referuese të parashtruar nga z. Januzi, z. Bahtijari dhe z. Shala.
11. Dhoma e shpalli të papranueshme Kërkesën Referuese në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës, nenit 49(3) të Ligjit dhe rregullës 14(f) të Rregullores së DHSGJK-së, sepse pas shqyrtimit *prima facie*, asgjë në Kërkesën Referuese nuk ngre dyshime për shkelje të të drejtave kushtetuese të parashtruesve⁵.

III. ANKESA DHE KËRKESA REFERUESE

12. Në emër të katër parashtruesve, mbrojtësit pretendojnë se:
 - a) të drejtat e klientëve të tyre sipas neneve 30 dhe 31 të Kushtetutës, si dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa") u shkelën kur Administratorja miratoi Rregulloren për Ndihmë Juridike të Rishikuar në shkurt 2024. Ky rishikim i Rregullores për Ndihmë Juridike përmbante një ndryshim nga Rregullorja e mëparshme, e cila bëri një dallim ndërmjet honorarëve të akorduara për kategori të ndryshme të veprave penale, duke akorduar më pak fonde për pagesën e mbrojtjes në

³ KSC-CC-2024-23 (1) Sabit Januzi, (2) Ismet Bahtijari dhe (3) Haxhi Shala kundër Zyrës Administrative të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

⁴ KSC-CC-2024-23/F00005, Kërkesë e Kilajt për t'iu Bashkuar Kërkesës Referuese drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, publike, 21 prill 2024.

⁵ KSC-CC-2024-23/F00006, para. 21



çështje gjyqësore për vepra penale të pretenduara kundër administrimit të drejtësisë. Mbrojtësit e të katër parashtruesve argumentojnë se sistemi i ri për Ndihmë Juridike do të rezultojë në akordim të fondeve të pamjaftueshme për përfaqësim të efektshëm të të akuzuarve, çka shkel të drejtat themelore të tyre;

- b) KSC-BD-25/Rev1 u miratua pa ndonjë proces këshillues. Gjithashtu, miratimi i KSC-BD-25/Rev1 jo vetëm që ndikon drejtpërdrejt në përfaqësimin e efektshëm të z. Januzi dhe të bashkakuzuarve të tij, z. Bahtijari dhe z. Shala, por ka gjithashtu pasoja të gjera në të ardhmen në lidhje me të drejtat dhe interesat e cilitdo personi të dyshuari apo të akuzuar të ardhshëm që sillet para Dhomave të Specializuara për proces gjyqësor të mosbindjes (përfshirë z. Kilaj i cili tashmë është në paraburgim); dhe
- c) kërkesa që Avokati i Popullit të ushtrojë kompetencën e tij sipas nenit 49(5) të Ligjit nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) t’ia përcjellë aspektin e vlefshmërisë kushtetuese Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese si çështje urgjente duke pasur parasysh se mbrojtja e ankuesve nuk ka fonde, dhe z. Januzi dhe të bashkakuzuarit e tij, z. Bahtijari dhe z. Shala janë në pritje të gjykimit, për të cilin data e kalimit të dosjes së çështjes gjyqësore Trupit Gjykues është caktuar 21 qershori 2024.
- d) krahas kësaj, dr. Felisiti Geri, mbrojtësja e z. Bahtijari, në parashtrimin e saj drejtuar Avokatit të Popullit paraqiti aspektet shtesë në vijim:

(1) ajo tha se nuk është paguar që nga caktimi i saj më 4 janar 2024, se ka mbi 200 parashtrime të protokolluara dhe një situatë e tillë është e padrejtë (dhe stresuese) për të dhe klientin e saj. Dr. Geri u ankua se nuk ekziston asnjë mekanizëm për pagesë të mbrojtësve në pritje të miratimit të fondit për Ndihmë Juridike, aspekt ky që ajo mendon se Avokati i Popullit duhet ta shqyrtojë.

(2) Më tutje ajo thotë se i ka shkruar Organit Përfaqësues të Pavarur nga i cili nuk ka marrë përgjigje, dhe kërkon që Avokati i Popullit të shqyrtojë aspektin e tërheqjes së mbrojtësit për shkak të mungesës së fondeve.

IV. DISPOZITAT LIGJORE

13. Sipas nenit 34(9) të Ligjit, Avokati i Popullit kryen funksionet e veta me përgjegjësi ekskluzive për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Roli dhe funksioni i Avokatit të Popullit të Dhomave të Specializuara përcaktohen në Rregulloren e Procedurës dhe të Provave.



14. Rregulla 28(2) e Rregullores së Procedurës dhe të Provave (RRPP) përcakton fushëveprimin e juridiksionit të Avokatit të Popullit i cili përfshin vetëm monitorimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave themelore të personave që kanë kontakt me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.
15. Rregulla 29(1) e RRPP-së thotë se Avokati i Popullit nuk ndërhyt në çështje gjyqësore ose procese të tjera ligjore para Dhomave të Specializuara, me përjashtim të rasteve në lidhje me vonesa të paarsyeshme.
16. Në bazë të rregullës 29(2) (a) të RRPP-së, Avokati i Popullit mund të kryejë hetime në lidhje me ankesa të paraqitura prej kujtdo që pretendon shkelje të të drejtave të veta nga Dhomat e Specializuara apo Zyra e Prokurorit të Specializuar.
17. Në përputhje me rregullën 29(3) të RRPP-së, një kërkesë drejtuar Avokatit të Popullit mund të hidhet poshtë nëse:
 - (a) ka të bëjë me një çështje gjyqësore ose procese të tjera ligjore para Dhomave të Specializuara, dhe jo në lidhje me pretendime për vonesa të paarsyeshme;
 - (b) kërkesa nuk tregon shkelje të të drejtave të njeriut prej Dhomave të Specializuara;
 - (c) është e paplotë, ose nuk është plotësuar në përputhje me shkresën kujtuese të Avokatit të Popullit;
 - (d) nuk janë përdorur të gjitha mjetet juridike të mundshme, përveçse në rast mosveprimi apo rrethanave më të ngutshme për të parandaluar dëm të rëndë dhe padrejtësi të pandreqshme.
18. Në bazë të nenit 49(5) të Ligjit, Avokati i Popullit mund t'i paraqesë Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese kërkesa referuese sipas nenit 113(2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ('Kushtetuta e Kosovës,' ose 'Kushtetuta')⁶.
19. Bazuar në të drejtën materiale, Avokati i Popullit ka kompetencë të zbatojë instrumentet e të drejtave të njeriut të përcaktuara në Kapitullin II të

⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, qershor 2008 (me ndryshimet e vitit 2020).



Kushtetutës së Kosovës. Rrjedhimisht, KEDNJ-ja, KNDCP-ja dhe Kushtetuta e Kosovës kanë rëndësi të veçantë për punën e Avokatit të Popullit sepse përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhen garantuar nga autoritetet publike në një shoqëri demokratike.

V. VLERËSIMI I AVOKATIT TË POPULLIT

i) Kërkesa drejtuar Avokatit të Popullit për të ushtruar kompetencën e tij sipas nenit 49(5) të Ligjit nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") për t'ia referuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese aspektin e kushtetutshmërisë të KSC-BD-25/Rev1.

20. Rregulla 26 e Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese kërkon që çdo referim nga Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara ose nga Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës në bazë të nenit 49(5) të Ligjit, parashtrohet brenda dy (2) muajsh nga hyrja në fuqi e ligjit të kundërshtuar.⁷

21. Në rastin aktual, Administratorja miratoi ndryshimet në Rregulloren për Ndihmë Juridike më 22 shkurt 2024 dhe KSC-BD-25/Rev1 hyri në fuqi po atë ditë.

22. Kërkesa e parashtruesve të ankesës drejtuar Avokatit të Popullit për t'ia referuar Rregulloren Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, u parashtrua më 25 prill 2024.

23. Duke pasur parasysh se afati për dorëzim të kërkesës referuese përfundoi më 23 prill 2024, Avokati i Popullit nuk mund të shqyrtojë asnjë kërkesë të ankuesve për t'ia referuar Dhomave të Specializuara Gjykatës Kushtetuese Rregulloren për Ndihmë Juridike të rishikuar.

ii) Shkeljet e pretenduara të të drejtave të parashtruesve të ankesës sipas neneve 30 dhe 31 të Kushtetutës, si dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa") si rezultat i miratimit nga Administratorja të disa ndryshimeve në Rregulloren për Ndihmë Juridike të vitit 2020.

⁷ Kapitulli 4, Pjesa IV, rregulla 26 e Rregullores së Procedurës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.



24. Gjatë shqyrtimit nëse një ankesë ose ndonjë pjesë e ankesës do të analizohet, Avokati i Popullit fillimisht kryen një vlerësim paraprak në përputhje me dispozitat e rregullave 29(1) dhe 29(3) (a)-(e) të RRPP-së. Avokati i Popullit duhet të bindet se ai ka kompetencë për të shqyrtuar ankesën përkatëse.
25. Rregulla 29(1) e RRPP-së thotë se Avokati i Popullit nuk ndërhyt në çështje gjyqësore ose procese të tjera ligjore para Dhomave të Specializuara, me përjashtim të rasteve në lidhje me vonesa të paarsyeshme.
26. Në përputhje me rregullën 29(3)(a) të RRPP-së, kërkesa drejtuar Avokatit të Popullit mund të hidhet poshtë nëse ka të bëjë me një çështje gjyqësore ose procese të tjera ligjore para Dhomave të Specializuara, dhe jo në lidhje me pretendime për vonesa të paarsyeshme.
27. Gjatë shqyrtimit të dispozitave të rregullave 29(1) dhe 29(3)(a) të RRPP-së, Avokati i Popullit citon vlerësimin e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese⁸ në vendimin e vet në lidhje me Kërkesën Referuese të parashtruesve:
- “Dhoma thekson gjithashtu se procesi kundër parashtruesve është në kryerje e sipër dhe se së pari u takon dhomave penale të vlerësojnë nëse shkeljet e pretenduara kanë ndonjë bazë dhe nëse kjo mund të korrigohet ose duhet korrigjuar gjatë procesit gjyqësor. Në këtë drejtim, Dhoma thekson se Rregullorja për Ndihmë Juridike e vitit 2024 parasheh një mekanizëm për rishikim nga një panel kompetent të çdo vendimi mbi ndihmë juridike.”*
28. Në lidhje me këtë, Avokati i Popullit nuk mund të devijojë ose anashkalojë vlerësimin e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me aspektet konkrete në fjalë që përfshihen në ankesën nën shqyrtim.
29. Avokati i Popullit ka thënë më parë se atij nuk i lejohet të konkurrojë me mbrojtjen juridike që ofrojnë gjykatat. Të dy konceptet kanë qëllim të përbashkët – mbrojtjen e të drejtave të njeriut, por ato bazohen në koncepte krejtësisht të ndryshme organizative dhe funksionale. Avokati i Popullit ka kompetenca rekomanduese për parandalimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe avancimin e mbrojtjes së këtyre të drejtave, ndërsa gjykatat duhet të vendosin

⁸ KSC-CC-2024-23(1) Sabit Januzi, (2) Ismet Bahtijari dhe (3) Haxhi Shala kundër Zyrës Administrative të Dhomave të Specializuara të Kosovës, para. 20.



për raste individuale dhe mundësojnë vënien në zbatim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.⁹ Kjo pasqyrohet në rregullat 29(1) dhe 29(3)(a) të RRPP-së.

33. Në lidhje me këtë, Avokati i Popullit thekson se procesi gjyqësor kundër të katër parashtruesve është në vazhdim e sipër para Dhomave të Specializuara. Sikurse u cek nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, mbrojtja e të drejtave themelore të garantuara në nenet 30 dhe 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut) së pari u takon dhomave penale.
34. Rrjedhimisht, në përputhje me rregullën 29(1) dhe rregullën 29(3)(a) të RRPP-së, Avokati i Popullit duhet ta rrëzojë ankesën në tërësi, sepse ai e ka të ndaluar të ndërhyjë në çështje gjyqësore ose procedura të tjera ligjore para Dhomave të Specializuara.
35. Krahas kësaj, dr. Felisiti Geri, mbrojtësja e z. Bahtijari, paraqiti aspekte shtesë në parashtrimin e saj drejtuar Avokatit të Popullit.
- (1) ajo tha se ajo nuk është paguar që nga caktimi i saj më 4 janar 2024, se ka mbi 200 parashtrime të protokolluara dhe një situatë e tillë është e padrejtë (dhe stresuese) për të dhe klientin e saj. Dr. Geri u ankua se nuk ekziston asnjë mekanizëm për pagesë të mbrojtësit në pritje të miratimit të fondit për Ndihmë Juridike, gjë që ajo mendon se Avokati i Popullit duhet ta shqyrtojë.
- (2) Më tutje ajo thotë se i ka shkruar Organit Përfaqësues të Pavarur nga i cili nuk ka marrë përgjigje, dhe kërkon që Avokati i Popullit të shqyrtojë aspektin e tërheqjes së mbrojtësit për shkak të mungesës së fondeve.
36. Avokati i Popullit thekson se Rregullorja për Ndihmë Juridike e vitit 2024 parasheh caktimin dhe pagesën me kusht të mbrojtësit si dhe të Ndihmës Juridike.
37. Avokati i Popullit rikujton se sipas rregullës 6 dhe rregullës 22 të Rregullores së vitit 2024, pasi mbrojtësi ka dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme, Administratorja mund të caktojë mbrojtësin sipas rregullës 11, në pritje të vendimit përfundimtar mbi ndihmën juridike.
38. Avokati i Popullit është i mendimit se aspektet e paraqitura nga dr. Geri janë të llojit administrativ dhe nuk është paraqitur, as parashtruar asnjë argument në

⁹ OMB-C-2022-02, Raporti i Avokatit të Popullit pas hetimit në lidhje me ankesën e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit kundër Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës dhe Dhomave të Specializuara të Kosovës, 20 shkurt 2023, para. 72



mbështetje të pretendimit se ato kanë rezultuar në shkelje të të drejtave themelore të klientit të saj sikurse përcaktohen në Kapitullin II të Kushtetutës.

39. Rrjedhimisht, në përputhje me rregullën 29(3)(b) të RRPP-së, Avokati i Popullit duhet të hedhë poshtë këtë element të ankesës.

VI. PËRFUNDIM

40. Avokati i Popullit ka arritur në përfundimin se kërkesa për t'ia referuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese Rregulloren për Ndihmë Juridike të vitit 2024, duhet të rrëzohet, për shkak se ka përfunduar afati për një kërkesë referuese të tillë.

41. Avokati i Popullit ka arritur në përfundimin se ankesat që kanë të bëjnë me shkelje të pretenduara të të drejtave të parashtruesve të ankesës sipas neneve 30 dhe 31 të Kushtetutës, si dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa") si rezultat i miratimit nga Administratorja të Rregullores për Ndihmë Juridike të Rishikuar në shkurt 2024 lidhen konkretisht me procesin gjyqësor para Gjykatës, përfshihen në juridiksionin e dhomave penale dhe rrjedhimisht, duhet të rrëzohen në bazë të rregullës 29(1) dhe 29(3)(a) të RRPP-së.

42. Së fundi, Avokati i Popullit konstaton se ankesat konkrete nga dr. Geri në lidhje me mospagesë që nga caktimi më 4 janar 2024, pretendimin se nuk ka mekanizëm për pagesë të mbrojtësit në pritje të akordimit të ndihmës juridike, dhe kërkesës së saj që Avokati i Popullit të shqyrtojë aspektin e tërheqjes së mbrojtësit në mungesë të fondeve duhet të rrëzohen në bazë të rregullës 29(3)(b) të RRPP-së, sepse aspektet në fjalë nuk përfshihen në kompetencën e tij. Ato janë aspekte administrative dhe dr. Geri nuk ka paraqitur asnjë pretendim se përbëjnë shkelje të të drejtave themelore të klientit të saj, sikurse përcaktohen në Kapitullin II të Kushtetutës.

Pietro Spera

Avokat i Popullit, Dhomat e Specializuara të
Kosovës

8 maj 2024
Në Hagë, Holandë.